



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



Anr.517/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Burim Ademi dhe Ferki Xhaferi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë dega Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - Thyerja e heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 18.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet e palejuar ankesa A.nr.517/2021 e dates 16.02.2021, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë dega Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, pasi që për të njëjtën çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 382/2021 të datës 15.02.2021.

A r s y e t i m

Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë dega Mitrovicë, ka parashtruar ankesë A.nr.517/2021 me datë 16.02.2021, me të cilën pretendon se me datën 14.02.2021 në ora 12:08 anëtare te subjektit politik LVV kane pranuar një mesazh nëpërmjet telefonik të SMS-ve me tekstin “ Kosova ka nevojë për një president të fort të dëshmuar. Qytetar te Kosovës zgjedhjen keni te AAK-135 voto R. Haradinaj për president. Parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim i subjekti politik AAK Rregullës Zgjedhore të KQZ-se 11/2013 neni 7 paragrafi b). Si provë ka bashkangjitur fotografi me mesazhin për rastin në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit të lejushmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë dega Mitrovicë, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesat e parashtruara nga subjekti politik LVV dhe Birn dhe Internews Kosova IKS të paraqitura me datën 14 dhe 15 shkurt 2021 kundër subjektit politik AAK e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 382/2021 të datës 15.02.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se ankesa e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë dega Mitrovicë është çështje e gjykuar “res iudicata”.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 382/2021 të datës 15.02.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 517/2021 më datën 18.02.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së,